

FJALA E DEPUTETIT FLAMUR NOKA

E HËNË 11 PRILL 2022

Zonjë, është e disata herë që ju vazhdoni dhe e përdhosni Rregulloren e këtij Kuvendi. Tani çështjen e grupeve e diskutoi kolegu im Bylykbashi. Nuk ka asnjë pikë që mua më largon nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, as ti, as Lindita, as Edi Rama, askush, së pari. Së dyti, nëse paskemi kohën sipas nenin 40 pika 1, siç thatë ju, dikush nga grupi ynë, që kemi 21 minuta, ka qenë zonja Vokshi, ajo do të bënte në emrin tonë ndarjen e minutave.

Me çfarë të drejtë ti, zonjë, i jep dikujt 4 minuta, dikujt 5 diku 2 minuta. Se të thuash që ke 2 minuta për të folur do të thotë të tallësh, sepse dy minuta mund të thuash vetëm se sot paske veshur xhaketën e bukur, por fustanin nuk e ke aq të bukur, vetëm kaq mund të thuash në 2 minuta. Tani, ju lutem, mos u tallni! Është hera e fundit që ndodh. Që nga sot do të kemi kohën e duhur, e ndajmë vetë, nuk na e ndan ti. Ta mbyllim dhe të mos kemi diskutime për këtë pikë!